“Ai që thërret në udhëzim, do të ketë shpërblim aq sa kanë edhe ata që e pasojnë, pa u zvogëluar aspak shpërblimi i atyre

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ai që thërret në udhëzim, do të ketë shpërblim aq sa kanë edhe ata që e pasojnë, pa u zvogëluar aspak shpërblimi i atyre, por edhe ai që thërret në lajthitje, do të ketë mëkat po aq sa kanë edhe ata që e pasojnë, pa u zvogëluar aspak mëkati i tyre.”
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se ai që i udhëzon dhe i nxit njerëzit drejt një rruge në të cilën ka hak (të vërtetë) dhe mirësi, qoftë me fjalë, qoftë me vepër, do të ketë shpërblim të ngjashëm me atë të atyre që e pasojnë, pa iu zvogëluar shpërblimi i këtyre të fundit. Po ashtu, ai që i udhëzon e i përudh njerëzit drejt një rruge të kotë dhe të keqe që përmban mëkat dhe të bërët keq ose diçka që nuk lejohet, qoftë me fjalë, qoftë me vepër, atëherë ai do ta bartë barrën e barabartë të mëkatit të atyre që e ndjekin, pa u zvogëluar asgjë nga mëkatet e tyre.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/3373